L I G J
Nr.9204, datë 15.3.2004

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR TRANSPORTIN DETAR TREGTAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për transportin detar tregtar", nënshkruar në Sofje më 13 qershor 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4190, datë 5.4.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE DYPALËSHE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR TRANSPORTIN DETAR TREGTAR

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, më poshtë të quajtura "Palë Kontraktuese";

duke njohur rëndësinë e zhvillimit të transportit detar tregtar ndërmjet të dy vendeve; bazuar në principet e barazisë dhe të interesit reciprok;

duke dëshiruar të forcojnë bashkëpunimin në fushën e transportit detar tregtar, mbi bazën e principeve të lirisë së transporteve,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. Me shprehjen "Anije e Palës Kontraktuese" kuptohet çdo anije, e regjistruar në përputhje me legjislacionin e Palëve Kontraktuese dhe që mbajnë flamurin e shtetit, si dhe çdo anije që merret me qira. "Anije me qira" do të kuptojmë çdo anije, regjistruar në një vend të tretë në përputhje me legjislacionin e tij, që lundron me flamurin e atij shteti dhe operohet nga një person fizik ose juridik të një prej Palëve Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre. Ky term nuk përfshin anijet luftarake dhe anijet e tjera që përdoren për qëllime jotregtare, si: hidrografike, kërkime shkencore dhe anijet e peshkimit.

2. Me shprehjen "Anëtar i ekuipazhit" do të kuptohet kapiteni dhe çdo person tjetër, i përfshirë në listën e ekuipazhit të anijes, që ndodhet në atë moment në bord dhe që ushtron funksione që kanë të bëjnë me drejtimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin gjatë lundrimit.

3. Autoritetet kompetente janë:
- Për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit,
- Për Republikën e Bullgarisë, Ministria e Transportit dhe e Komunikacioneve.

Neni 2

Marrëveshja aktuale zbatohet në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në territorin e Republikës së Bullgarisë.

Neni 3

Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë në fushën e transportit detar tregtar do të bazohet në principet e barazisë, njohjes së pavarësisë kombëtare dhe interesit reciprok.

Palët Kontraktuese do t'i ofrojnë njëra-tjetrës asistencën e nevojshme për zbatimin e parimit të lirisë në transportin detar tregtar dhe nuk do t'i referohen marrjes së masave të cilat bllokojnë lundrimin detar.

Neni 4

Palët Kontraktuese do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet ndërmarrjeve, organizatave dhe autoriteteve, të cilat operojnë në fushën e transportit detar në vendet e tyre.

Neni 5

1. Palët Kontraktuese ranë dakord:

a) Të nxisin përfshirjen e anijeve të Palëve Kontraktuese në furnizimin e shërbimeve të transportit detar ndërmjet porteve të vendeve të tyre.

b) Të bashkëpunojnë në eliminimin e pengesave, të cilat mund të dëmtojnë zhvillimin e transportit ndërmjet porteve të vendeve të tyre.

c) Të abstenijë nga vonesa e anijeve të njërës nga Palët Kontraktuese për të siguruar shërbimin e transportit detar ndërmjet porteve të Palës tjetër Kontraktuese për të siguruar shërbimin e transportit detar ndërmjet porteve të Palës tjetër Kontraktuese dhe porteve të vendeve të treta.

2. Klauzolat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të cenojnë të drejtën e anijeve të vendeve të treta që të marrin pjesë në shërbimet e transportit detar ndërmjet porteve të Palëve Kontraktuese.

Neni 6

1. Secila nga Palët Kontraktuese do t'u rezervojë anijeve të Palës tjetër Kontraktuese, të njëjtin trajtim që u rezervojnë anijeve të tyre në lidhje me: hyrjen e lirë në porte, kushtet e kalatave, pajisjet e ngarkim-shkarkimit, imbarkimin dhe disimbarkimin e pasagjerëve, vënien e taksave portuale dhe shërbimet e kryera, kur ato lidhen me anije detare tregtare.

2. Klauzolat e paragrafit 1 të këtij neni nuk:

a) do të zbatohen në portet e mbyllura për anijet e huaja;

b) do të zbatohen për aktivitetet e rezervuara nga secila Palë Kontraktuese për ndërmarrjet dhe organizatat e veta, si: kabotazhi, operacionet e shpëtimit dhe të rimorkimit;

c) do të zbatohen në përjashtimin nga rregullat për pilotimin e detyrueshëm;

d) do të shkelen për zbatimin e rregullave, në lidhje me lejimin, qëndrimin dhe largimin e të huajve të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 7

Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme, brenda kuadrit të legjislacionit të tyre kombëtar, për të lehtësuar dhe për të nxitur transportin detar, për të evituar vonesën e anijeve në port, si dhe për të lehtësuar dhe për të shpejtuar sa më shpejt të jetë e mundur, bërjen e formaliteteve doganore dhe të formaliteteve të tjera që zbatohen në portet e tyre.

Neni 8

1. Secila nga Palët Kontraktuese do të njohë dokumentet, certifikatën e kombësisë së anijes, certifikatën e tonazhit dhe të gjitha dokumentet e tjera zyrtare të anijes, lëshuar ose njohur nga Pala tjetër Kontraktuese.

2. Anijet e secilës Palë Kontraktuese që kanë Certifikatën Ndërkombëtare të Tonazhit do të përjashtohen nga çdo matje në portet e Palës tjetër Kontraktuese. Kjo certifikatë do të përdoret si bazë për llogaritjen e taksave portuale.

Neni 9

Secila nga Palët Kontraktuese do t'i njohë dokumentet e identitetit të detarëve, të lëshuara nga autoritetet respektive të Palës tjetër Kontraktuese.

Këto dokumente të identitetit do të jenë:

- Për Republikën e Shqipërisë, pasaporta e detarit
- Për Republikën e Bullgarisë, pasaporta e detarit

Ky dokument do t'i garantojë mbajtësit kthimin në vendin që ka lëshuar atë.

Neni 10

Anëtarët e ekuipazhit të anijes të secilës Palë Kontraktuese, që mbajnë dokumentet e identitetit sipas nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje, lëshuar nga njëra Palë, mund të lejohen gjatë qëndrimit të anijes në portin e Palës tjetër Kontraktuese, të zbresin në tokë dhe të dalin në qytetin e portit ku ndodhen, pa viza, kur kapiteni i anijes ka njohur organet lokale kompetente me listën e ekuipazhit.

Këta persona do të jenë subjekt i procedurës së kontrollit kur imbarkohen dhe disimbarkohen nga anija.

Neni 11

1. Secila Palë Kontraktuese do t'i njohë referimet e nenit 9 në lidhje me dokumentet e identifikimit, lëshuar nga Pala tjetër Kontraktuese, kur mbajtësit e këtij dokumenti kanë nevojë të qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese ose të kalojnë nëpërmjet territorit të saj, për t'u kthyer në bordin e anijes së tyre, për t'u kthyer në vendin e tyre ose për ndonjë qëllim tjetër, të pranuar nga kjo Palë Kontraktuese pavarësisht nga mjeti i transportit i përdorur, me kusht që këta persona të zbatojnë ligjet dhe rregullat e së njëjtës Palë Kontraktuese.

2. Secila Palë Kontraktuese do të lejojë anëtarët e ekuipazhit të anijes së Palës tjetër Kontraktuese që të qëndrojnë në spitalet në territorin e saj për periudhën e kohës që kërkohet për trajtimin mjekësor.

Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin kombëtar, do të sigurojë ndihmën e nevojshme mjekësore për anëtarët e ekuipazhit të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 12

Parashikimet e neneve 9, 10 dhe 11 do të zbatohen për çdo person i cili nuk është shtetas i secilës Palë Kontraktuese, por zotëron dokument identifikimi, në përputhje me parashikimet e Konventën e lehtësimit të trafikut ndërkombëtar detar, 1965 dhe bashkëngjitur për më tepër Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) Nr.108 të dokumenteve të identifikimit të detarit. Dokumente të tilla identifikimi do të lëshohen nga vendi, anëtar i konventës respektive, dhe do të garantojë mbajtësin e saj të drejtën e kthimit në vendin e lëshimit.

Neni 13

1. Parashikimet e neneve 9-11 të kësaj Marrëveshjeje janë pa pasoja për rregullat kombëtare dhe rregulloret për hyrjen dhe daljen e të huajve nga dhe për në territorin e secilës Palë Kontraktuese.

2. Palët Kontraktuese rezervojnë të drejtën për të mos lejuar hyrjen dhe qëndrimin në territorin e tyre të personave që konsiderohen të padëshirueshëm.

Neni 14

Për qëllime të sigurisë, kapitenit të anijes të secilës Palë Kontraktuese i lind e drejta që, për të vazhduar lundrimin, të marrë detarë nga Pala tjetër Kontraktuese. Punësimi do të jetë vullnetar dhe në përputhje me legjislacionin e shtetit, flamurin e të cilit mban anija.

Neni 15

1. Në qoftë se një anije e njërës nga Palët Kontraktuese përplaset, mbytet, bie në cekëtinë ose pëson ndonjë avari, ose ndonjë incident tjetër në ujërat territoriale ose brigjet e Palës tjetër Kontraktuese, autoritetet kompetente të kësaj Pale do të garantojnë një ndihmë dhe bashkëpunim për mbrojtjen e pasagjerëve, ekuipazhit, vetë anijes dhe ngarkesës së njëjtë me atë që i garantohet anijeve që lundrojnë me flamurin e saj.

2. Në qoftë se një anije e njërës Palë Kontraktuese pëson një dëm në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, ngarkesa e saj, pajisjet dhe prona të tjera do të përjashtohen nga TVSH-ja, taksat dhe tarifat, përveç në rastin kur ato janë destinuar për konsum të drejtpërdrejtë dhe përdorim në territorin e kësaj Pale Kontraktuese.

3. Parashikimet e paragrafit 2 të këtij neni nuk do të bien në kundërshtim me ligjet, rregullat e kohës së magazinimit të mallrave, në territorin e Palës Kontraktuese.

Neni 16

Ndërmarrjet e transportit dhe organizatat e secilës Palë Kontraktuese kanë të drejtë të ngrejnë zyra agjencie në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Aktiviteti i këtyre zyrave do të jetë në përputhje me ligjet e vendit në territorin e të cilit ato janë ngritur.

Neni 17

1. Secila nga Palët Kontraktuese do t'u garantojë ndërmarrjeve detare dhe organizatave të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën të përdorë të ardhurat dhe çfarëdo tjetër të realizuar në territoret e tyre nga aktivitetet e zhvilluara në zbatim të kësaj Marrëveshjeje për të mbuluar shpenzimet që do të kryhen në atë vend.

Secila nga Palët Kontraktuese do t'u garantojë ndërmarrjeve dhe organizatave detare të Palës tjetër Kontraktuese të drejtën për të transferuar të gjitha të ardhurat e mbetura pas kryerjes së pagesave të mësipërme. Ndërmarrjet dhe organizatat detare do të veprojnë kështu në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi.

2. Të gjitha pagesat që rezultojnë nga aktivitetet e rregulluara nga kjo Marrëveshje do të bëhen me çdo monedhë të huaj të konvertueshme në përputhje me interesat e organizatave të të dyja Palëve Kontraktuese.

Neni 18

1. Autoritetet kompetente të secilës Palë Kontraktuese nuk do të përfshihen në konfliktet civile ndërmjet pronarit të anijes, kapitenit dhe anëtarëve të tjerë të ekuipazhit, në lidhje me marrëdhëniet

dhe kushtet e punës në bordin e anijes të Palës tjetër Kontraktuese.

2. Secila Palë Kontraktuese mund të ushtrojë procedurë gjyqësore për çdo krim, të ndodhur në bordin e anijes të Palës tjetër Kontraktuese, kur një anije e tillë qëndron në portet ose ujërat territoriale të saj.

3. Asnjë Palë Kontraktuese nuk mund të ushtrojë procedurë gjyqësore për çdo krim, të ndodhur në bordin e anijes të Palës tjetër Kontraktuese, kur një anije e tillë kalon transit në ujërat e saj territoriale, me përjashtim të rasteve të mëposhtme:

a) Në qoftë se krimi prish qetësinë e shtetit ose rregullin e vendosur në ujërat e saj territoriale.

b) Si pasojë e krimit cenohen interesat shtetërorë ose të qytetarëve të saj.

c) Për parandalimin e tregtisë ilegale të lëndëve narkotike, të substancave të rrezikshme dhe radioaktive.

d) Në qoftë se miratimi është dhënë nga kompetencat diplomatike ose konsulli i shtetit, flamurin e të cilit mban anija.

e) Në qoftë se krimi është në kundërshtim me paqen dhe njerëzimin.

4. Parashikimet e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk cenojnë të drejtën e autoriteteve të secilës Palë Kontraktuese për të kontrolluar dhe investiguar ngjarjet në përputhje me legjislacionin e tyre.

Neni 19

Kur është e nevojshme, përfaqësues të organeve kompetente të Palëve Kontraktuese, do të takohen respektivisht në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Bullgarisë për të diskutuar çështje në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ose çështje të tjera me interes të përbashkët në lidhje me transportin detar.

Neni 20

Çdo kundërshtim në lidhje me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje do të vendoset nëpërmjet negociatave direkte ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Në qoftë se Marrëveshja nuk arrihet gjatë negociatave, konflikti do të zgjidhet në rrugë diplomatike.

Neni 21

Marrëveshja do të vendoset për një kohë të pacaktuar dhe do të hyjë në fuqi pas 30 ditësh pas datës së marrjes së njoftimit të dytë me anë të të cilit Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën se të gjitha kërkesat e legjislacionit kombëtar, të aplikueshme në vendet e tyre respektive, janë marrë parasysh.

Kur kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi, vlefshmëria e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Bullgarisë dhe Qeverisë së Republikës Socialiste të Shqipërisë "Për transportin detar tregtar" firmosur më 19 maj 1990 në Tiranë automatikisht do të ndërpritet.

Secila Palë Kontraktuese mund ta denoncojë këtë Marrëveshje në çdo kohë me anë të njoftimit me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Denoncimi do të ketë efekt 6 muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Pala tjetër Kontraktuese.

Bërë në Varma, më 12. 6. 2003, në tri kopje origjinale, në gjuhët shqip, bullgarisht dhe anglisht. Të tre tekstet janë të njëjtë. Në rast të divergjencave në interpretim, teksti në anglisht është i pranueshëm.